

Programi për konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME)

Bazuar në Axhendën e Selanikut 2003, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të marrin pjesë në Programet Evropiane. Këto Programe konsiderohen si një instrument mbështetës në procesin e stabilizimit asociimit (SAP) si dhe në procesin e përafrimit me BE-në.

*Programet evropiane ku Shqipëria është pjesë:
[Programet Evropiane](#)*

COSME është programi i BE-së që ndihmon sipërmarrësit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në fazën fillestare të aktivitetit, lehtëson aksesin në financim, ndërkombëtarizimin e tyre, si dhe mbështet autoritetet për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të mundësuar rritjen ekonomike.

Ky program, në të cilin marrin pjesë vendet anëtare të BE-së, vendet candidate, vendet që aspirojnë statusin kandidat si dhe disa vende të tjera të rajonit, është një vazhdimësi e Programit kuadër për Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin (CIP) 2007-2013. Nga COSME do të përfitojnë SME-të respektive të vendeve pjesëmarrëse, organizatat që ofrojnë shërbime për biznesin, autoritetet qendrore dhe lokale.

Objektivat e programit janë:

1. Përmirësimi i aksesit të SME-ve në financim, i cili ndër të tjera ka për qëllim zhvillimin e një seti instrumentash financiarë, zhvillimin e zgjerimin e tregut të kapitaleve të BE-së, mbështetjen e huadhënies, përmirësimin e informacionit rreth financimeve të BE-së në dispozicion të SME-ve;
2. Përmirësimi i aksesit në treg (Rrjeti Evropian i Sipërmarrjeve "EEN", ndërkombëtarizimi i SME-ve, etj.);
3. Përmirësimi i kushteve të përgjithshme për konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve, sidomos SME-ve, duke përfshirë edhe sektorin e turizmit;
4. Nxitja e sipërmarrjes dhe e kulturës së sipërmarrjes.

Përveç mbështetjes së ndërkombëtarizimit, konkurrueshmërisë dhe kulturës sipërmarrëse, COSME mbetet kryesisht një instrument financiar që do të përmirësojë aksesin në financë për SME-të, koncept të cilit do t'i destinohet mbi 60% e buxhetit të përgjithshëm të programit.

Shqipëria, pas një aplikimi të suksesshëm në një prej thirrjeve kryesore të COSME-s, është bërë pjesë e rrjetit EEN (*Enterprise Europe Network*) i cili mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të përfituar sa më shumë nga mundësitë e biznesit të Bashkimit Evropian. Ndër të tjera, rrjeti ofron shërbime mbështetëse me vlerë të shtuar për biznesin që ndihmojnë SME-të në Tregun Unik të BE-së me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë.

[Rrjeti EEN](#)

- 🚩 Çdo vit, COSME miraton programin vjetor, ku përcaktohet buxheti lidhur me pilarët përkatës të programit, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe seleksionimit për përfituesit.

[Programi vjetor 2016](#)

- 🚩 Thirrjet e hapura për aplikime të Programit COSME

[Thirrjet aktuale](#)